



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 283/11 prot.

Tiranë, më 20.12.2024

VENDIM
Nr. 87, datë 20.12.2024

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 35, DATË 31.05.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 35, datë 31.05.2024, të Komisionerit, “Mbi paralajmërimin e institucionit, për zbatimin e ligjit gjatë administrimit të shërbimit civil në institucionin në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 70, datë 19.7.2023, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentit të Administratës Publike”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, institucion i administratës shtetërore në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (aktualisht në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit).

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 35, datë 31.05.2024, të Komisionerit, “Mbi paralajmërimin e institucionit, për zbatimin e ligjit gjatë administrimit të shërbimit civil

në institucionin në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me shkresën nr. 1084/2 prot., datë 25.11.2024, “Kthim përgjigje projektraportit për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në ISHPSHSH”, regjistruar pranë Komisionerit me nr.283/9 prot., datë 23.12.2024, institucioni ka informuar Komisionerin mbi ecurinë e procesit dhe veprimet e ndërmarra në përmbushje të detyrimeve të vendosura në dispozitivin e këtij vendimi.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 35, datë 31.05.2024, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, konstatoj se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e ISHPSHSH paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 2, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, të rregullojnë paligjshmëritë si më poshtë:

- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të përfundojë procesin e miratimit të përshkrimeve të punës për nëpunësit civil të institucionit të mbikëqyrur, duke i nënshkruar ato, në përputhje me kërkesat e ligjit;
- Njësia e burimeve njerëzore, të finalizojë procesin duke i depozituar këto akte pranë DAP-it;
- DAP të mbikëqyrë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, deri në finalizimin e tij.

Vërej se, për zbatimin e kësaj pike, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka informuar Komisionerin se me Urdhrin nr. 174, datë 10.09.2024, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPSHSH-së,” të Kryeministrit, ka filluar procesi i ristrukturimit. Institucioni objekt i mbikëqyrjes në vazhdim ka depozituar pranë Departamentit të Administratës Publike përshkrimet e punës, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë institut, mirëpo nga ana e DAP dhe Sekretarit të Përgjithshëm përshkrimet e punës nuk janë kthyer të miratuara.

Në përfundim të procesit të ristrukturimit, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me shkresën nr. 5988/141 prot., datë 6.11.2024, “Mbi transferimin e nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë të këtij institucioni.

Sa më sipër, në mënyrë verbale, nga ana e DAP i është komunikuar njësisë së burimeve njerëzore të ISHPSHSH se janë vlerësuar përshkrimet e punës dhe siç rezulton nga aktet

shkresore të depozituara pranë Komisionerit me shkresën nr. 1084/2 prot., datë 25.11.2024, të ISHPSHSH, në bazë të tyre, DAP ka kryer transferimet përkatëse.

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin Paralajmërues Nr. 35, datë 31.05.2024, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, i ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 35, datë 31.05.2024, të Komisionerit, “Mbi paralajmërimin e institucionit, për zbatimin e ligjit gjatë administrimit të shërbimit civil në institucionin në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit njësi përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha